

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
KOMITETI PËR AUDITIM



Raporti për punën e Komitetit për auditim për vitin 2022 (përmbledhje)

prill, 2023

Hyrje

Gjatë vitit 2022, Komiteti i Auditimit (Komiteti) ka vazhduar me aktivitetet e tij të rregullta në bazë të akteve dhe praktikave që e rregullojnë punën e tij. Komiteti ka kryer aktivitetet e tij mbikëqyrëse duke mbajtur seanca, në të cilat ka monitoruar punën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, Drejtorisë së Operacioneve Financiare dhe Kontabilitetit, Zyrës për strategji dhe preventivë si dhe procesin e kryerjes së auditimit të jashtëm të operacionit kontabël dhe raportimin financiar të Bankës Popullore.

Në këto seanca, Komiteti u informua rregullisht për fushat që mbikëqyr, në fushën e politikave kontabël dhe raportimit financiar, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kontrollet e brendshme dhe përputhshmërinë e operacioneve aktet ligjore dhe nënligjore. Për njohje më të detajuar në disa çështje, anëtarët e Komitetit kërkuar informacione shtesë dhe takime.

Anëtarët e Komitetit të Auditimit

Në bazë të Vendimit për emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit O nr. 02-15/XIX-2/2021, nga 3 dhjetor 2021, Komiteti i Auditimit, gjatë vitit 2022 ka punuar në përbërje me tre anëtarë joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore:

- Dr. Sinisha Naumoski, anëtar joekzekutiv i Këshillit të Bankës Popullore dhe kryetari i Komitetit;
- Dr. Gadaf Rexhepi, anëtar joekzekutiv i Këshillit; dhe
- Dr. Nikolla Popovski, anëtar joekzekutiv i Këshillit.

Seancat e Komitetit të Auditimit

Komiteti i Auditimit ka mbajtur tetë seanca në vitin 2022 ku janë shqyrtuar çështjet që hyjnë në fushën e Komitetit të Auditimit, sipas akteve të Bankës Popullore, Rregullores së Punës së Komitetit të Auditimit dhe Vendimit për themelimin e Komitetit të Auditimit dhe përcaktimi i fushëveprimit të tij. Në seanca, sipas nevojës, me ftesë të Komitetit kanë marrë pjesë: këshilltari i guvernatorit, shefi i auditimit të brendshëm Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, drejtori i Drejtorisë së Operacioneve Financiare dhe Kontabilitetit, drejtori i Drejtorisë së çështjeve Juridike, punimet dhe përfaqësuesit e auditorit të jashtëm.

Mbikëqyrja e funksionimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit i Bankës Popullore ka mbikëqyrur punën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, ka shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm, gjetjet dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

Rregullisht janë shqyrtuar raportet dhe programet e punës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përkatësisht:

- Raporti për funksionimin e auditimit të brendshëm në vitin 2021;
- Raporti për funksionimin e auditimit të brendshëm në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022; dhe
- Programi i punës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 dhe Programi afatmesëm i punës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2023 - 2025.

Mbikëqyrja e Drejtorisë së Operacioneve Financiare dhe Kontabilitetit

Komiteti i Auditimit i Bankës Popullore nga fusha mbikëqyrja e politikave të kontabilitetit dhe raportimit financiar, ka shqyrtuar:

- Vendimin për miratimin e Llogarisë vjetore dhe Raporteve financiare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021; dhe
- Vendimi për shpërndarjen e rezultatit financiar për shpërndarje për vitin 2021 të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

Anëtarët e Komitetit të Auditimit dhanë mendim deri te Këshilli i Bankës Popullore se janë të sigurt në *përshtatshmërinë dhe efektivitetin e procesit të përgatitjes së Raporteve financiare të Bankës Popullore për vitin 2021, ku janë respektuar të gjitha nivelet e kontroleve, vlerësimet kontabël dhe shpjegimet e lidhura janë të harmonizuara, dhe i propozuan Këshillit të Bankës Popullore të miratojë Vendimet e propozuara.*

Mbikëqyrja e funksionimit të auditimit të jashtëm

Një aktivitet i veçantë në punën e Komitetit ishte monitorimi i punës së auditimit të jashtëm. Komiteti ka mbajtur seanca me auditorët nga Shoqëria e auditimit "DILLOIT" Sh.P.K Shkup, për raportet financiare për vitin 2021 dhe ka arritur komunikim të mirë me auditorët e jashtëm. Kështu, auditori i jashtëm e informoi Komitetin për auditimin e kryer të raporteve financiare për vitin 2021 dhe të tyre pajtueshmërinë së tyre me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar.

Në Raportin e auditorit të pavarur për auditimin e kryer të raporteve financiare të Bankës Popullore për vitin 2021 është dhënë mendim pa kualifikim, përkatësisht mendim se raportet financiare të parashtuara, në mënyrë objektive paraqesin gjendjen financiare të Bankës Popullore më 31.12.2021 në të gjitha nga aspektet materiale, si dhe rezultatet e operacioneve dhe flukseve monetare për atë vit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. *Anëtarët e Komitetit e pranuan Raportin e Auditorit të Pavarur për auditimin e raporteve financiare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.*

Një aktivitet i veçantë në punën e Komitetit të Auditimit në vitin 2022 ishte monitorimi për zgjedhjen e një shoqërie të pavarur për auditimin e Raposteve financiare të bankës Popullore për një periudhë pesëvjeçare, përkatësisht për vitet: 2022, 2023, 2024, 2025 dhe 2026.

Komiteti i auditimit shqyrtoi *Raportin e procedurës së kryer - Shërbimet për auditim financiar dhe Informacioni për rrjedhën e procedurës së prokurimit publik – Shërbimet për auditim financiar*, përgatiti mendim lidhur me propozimin për përzgjedhjen e shoqërisë së jashtme për auditim, sipas së cilës vlerëson se procedura e prokurimit publik për zgjedhjen e një shoqërie për auditim të jashtëm të Bankës Popullore është kryer në përputhje me Politikën për zgjedhje, dhe i propozoi Këshillit të Bankës Popullore që të marrë Vendim për zgjedhjen e ofertës më të mirë. Sipas procedurës së zbatuar për prokurim publik, auditim të jashtëm të raporteve financiare të Bankës Popullore në pesë vitet e ardhëshme, do të kryej Shoqëria e auditimit "Grant Thornton".

Komiteti i auditimit në fund të vitit 2022, ka ndjekur procesin e inicimit të auditim i jashtëm për vitin 2022, konfirmoi se janë respektuar parimet e pavarësisë gjatë auditimit për vitin 2022 dhe gjithçka është në pajtim me Politikën e Përzgjedhjes së Shoqërisë për auditim të jashtëm të Raporteve Financiare të Bankës Popullore. Gjithashtu miratoi planin e aktiviteteve për auditimin e raporteve financiare të Bankës Popullore për vitin 2022 dhe ka rishikuar rekomandimet nga auditimi i mëparshëm i informacioneve financiare dhe sistemeve për regjistrimin financiar të Bankës Popullore, me gjendjen dhe për periudhën nëntëmujore që përfundon më 30 shtator 2022.

Mbikëqyrja e funksionimit të Zyrës për strategji dhe preventivë

Komiteti ka kryer aktivitete mbikëqyrëse lidhur me sistemin e vendosur të kontroleve të brendshme, kornizën e menaxhimit me rreziqe, me besueshmërinë e sistemit të informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me kornizën e përputhjes së operacioneve me rregulloret, me të cilat gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar dhe miratuar:

- Raporti për menaxhimin me rrezikun operativ në vitin 2021;
- Raporti vjetor për pajtueshmërinë e Bankës Popullore me rregulloret e mbrojtjes e të dhënave personale për vitin 2021;
- Raporti për menaxhimin me rreziqet operative të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjysmën e parë të vitit 2022.